

AA.nr.61/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështja Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Ragip Namani dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëseve M.,A. dhe Sh.H., që të gjithë nga ... Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson avokat H.P. nga Podujeva, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëseve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.431/2012 të datës 15.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 14.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëseve M.,A. dhe Sh.H., nga ... Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.431/2012 i datës 15.12.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.431/2012 të datës 15.12.2016, është refuzuar kërkesëpadia e paditëseve M.,A. dhe Sh.H., që të gjithë nga ... Komuna e Podujevës, për anulimin e aktvendimeve të paditurës Agjencisë Kadastrale të Kosovës, nr.09/122/12 të datës 23.02.2012, nr. 09/118/2012 të datës 01.03.2012, dhe 09/123/12 të datës 23.02.2012, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë kanë parashtruar paditësit përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim, av. H.P. nga Podujeva, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e ushtruar nga paditësit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore(LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Komuna e Podujevës - Drejtoria për Pronë, Kadastër, dhe Gjeodezi, ka iniciuar procedurën administrative për uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shoqërore, kundër paditësve, pastaj me aktvendimet nr.08.nr.466-08-3/11 të datës 21.12.2011 dhe nr.466-08-2/2011 të datës 22.11.2012 ka vërtetuar së paditësit M. dhe A.H. kanë uzurpuar

tokën në pronësi shoqërore në zonën Kadastrale nr.1329, fletë posedimi nr.181 Zona Kadastrale ... e cila është në pronësi shoqërore e Kuvendit Komunal Podujevë e cila vërtetohet me ekstraktin nga fletë posedimi i datës 21.09.2004. Të pa kënaqur me këtë aktvendim ankuesit parashtrajnë ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, e cila me aktvendimet nr.09/122/12 të datës 23.02.2012, nr.09/118/2012 datës 01.03.2012, dhe 09/123/12 të datës 23.02.2012, i refuzon ankesat si të pabazuara duke vërtetuar se ankuesit kanë uzurpuar në mënyrë arbitrare tokën në pronësi shoqërore në Zonën Kadastrale nr.1329, fletë posedimi nr.1181 Zona Kadastrale ...e cila është në pronësi shoqërore të Kuvendit Komunal Podujevë.

Paditësit të pakënaqur me aktvendimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kanë ushtruar padi për konflikt administrativ kundër të paditurës me pretendim se të njëjtit janë të paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësve, paraqitur kundër aktvendimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, nr.09/122/2012 të datës 23.02.2012, nr. 09/118/2012 të datës 01.03.2012, dhe 09/123/12 të datës 23.02.2012, në seancën e shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, padinë e paditësve e refuzon si të pabazuar duke e lënë në fuqi aktvendimet e kundërshtuara.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi aktvendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Andaj, duke u bazuar në provat e administruara, gjykata e shkallës së parë vendosi që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësve duke ju referuar Ligjit për shqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të krijuara me uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shoqërore nr.46/77 përkatësisht neneve 16,17 dhe 18 dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimeve të kontestuara në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës ka konstatuar se padia e paditësve është e pabazuar. Ngase në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, sepse me nenin 7.1 të Ligjit për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësoro - Juridike të krijuara me uzurpim arbitrar të tokës në pronësi shoqërore ("Gazeta Zyrtare e KSAK nr.46/77"), është paraparë që procedura për shqyrtimin e marrëdhënieve pasurore - juridike të krijuara me uzurpim arbitrar të tokave në pronësi shoqërore në shkallë të parë, procedon organi komunal i Drejtorisë kompetente për çështje pasurore - juridike - Organi i Administratës. Me nenin 9 të po këtij ligji parashihet që pas përfundimit të shqyrtimit, organi i administratës merr aktvendim me të cilin uzurpuesit arbitrar i njeh të drejtën e pronësisë së tokës së uzurpuar në mënyrë arbitrare ose ia merr këtë tokë. Në nenin 16 të këtij Ligji përcaktohet se nëse gjatë procedurës vërtetohet se uzurpimi arbitrar i tokës në pronësi shoqërore është kryer pas 14 shkurtit 1960, organi i administratës do të marrë aktvendim me të cilin do të caktoj që uzurpuesi arbitrar të largohet nga toka e uzurpuar në mënyrë arbitrare dhe ti largoj prej saj objektet nëse janë ngritur në këtë tokë. Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykata gjen se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur ka

lënë në fuqi aktvendimet e organit të paditur, sepse të njëjtit janë të bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit për Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pronësores - Juridike.

Ndërsa, sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë se paditëseve ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësve janë të pa bazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim edhe me provat në shkresat e lëndës. Ngase paditësit me asnjë provë nuk dëshmojnë pretendimet e tyre, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështjeje administrative juridike.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të ankimuar, se nuk është bërë kompensimi i palujtshmerisë së ekspropriuar, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse të njëjtat janë të vërtetuara dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa ne arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet e nevojshme mbi faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësve dhe lënies në fuqi të aktvendimeve të lartpërmendura, e pasi që me pretendimet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësve u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.61/2017, me datë 14.03.2017

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi